



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Janar, 2016

**Një marrëveshje që u prit mirë nga anëtarësia e SBASHK-ut
Takimet dhe dialogu sollën rezultatin e pritur**



Në kuadër të shumë aktiviteteve SBASHK-u kishte shtuar angazhimet që në takime me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës të arrinte marrëveshje për implementimin në praktikë të nenit 8, pika 6 , të Ligjit mbi Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky problem i nisur në prillin e vitit të kaluar rreth pensioneve të mësimdhënësve të Kosovës e që lidhej me vitet kontributdhënëse '89-'99 falë përkushtimit (faqe 5)

Përfaqësues të Qendrës për Politikë dhe Avokim vizituan SBASHK-un

Gatishmëri e ndërsjellë për bashkëpunim të frytshëm

Përfaqësuesit e Qendrës për Politikë dhe Avokim , z. Milaim Morina dhe z. Agim Kelmendi kanë vizituar selinë e ...(faqe 8)

Intervistë me
nënkryetaren e parë të SBASHK-ut :
zj.Nediha Grapci
Me krenari kujtojë gjithë arritjet e SBASHK-ut nëpër vite

Nediha Grapci tani më është në pension. Ajo në kohët më të vështira të shkollës shqipe ishte në radhët e para të aktiviteteve ...(faqe 3)

SBASHK-u organizon aktivitet qendror për ditën e mësuesit
Shprehet respekt për punën e madhe të kolegëve tanë që janë pensionuar



SBASHK-u edhe këtë vit do ta kremtojë 7 Marsin, këtë datë të madhe për shkollën shqipe. Duke shprehur respektin... (faqe 6)

SBASHK-u vazhdon bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar
Një grup intelektualësh sloven vizituan SBASHK-un



Qendra për Hulumtime dhe Zhvillime Edukative e Kosovës në bashkëpunim me Shkollën Ndërkombëtare për Studime ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Po vazhdojmë betejën për dituri



Erdhi shpejt viti 2016. Janari shënon rikthimin në vatrë arsimore për të vazhduar me betejën për dituri të reja.

SBASHK-u analizoi sfidat dhe arritjet në vitin 2015 dhe ishte vlerësim i përbashkët se kishte arritje. U konkludua se kemi kryer me përkushtim gjithë detyrat e përcaktuara e që janë varur nga vullneti dhe angazhimi ynë. Është e vërtetë se kanë mbetur edhe mjaft punë për t'u bërë e kërkesa për t'u realizuar. Për to duhet edhe përkushtimi dhe vullneti edhe i lalës tjetër, qoftë në nivelin lokal, qoftë në nivelin qendror të pushtetit.

Të punuarit në arsim do të vazhdojnë me angazhimet për arritje edhe më të mëdha në gjysmëvjetorin e dytë. Edhe anëtarët e SBASHK-ut në Universitet do të vazhdojnë me angazhimet, por edhe me përpjekjet që më dialog të arrijnë plotësimin e kërkesave të anëtarësisë. SBASHK-u e preferon dialogun dhe nuk ndalet se kërkuesi mundësi për bashkëpunim të sinqertë e për përpjekje të përbashkëta me të tjetër për realizimin e kërkesave, që

gjithmonë ishin dhe mbeten reale. Por, SBASHK-u e ka dëshmuar se kur dialogu nuk funksionon dhe nuk jep rezultate, atëherë bëhet organizim i përkryer i veprimeve sindikale. Urojmë që deri të kjo mos të vijë.

SBASHK-u apelon të mësimitdhënësit që të jenë unik dhe të vazhdojnë me përkushtimin për arritje të reja. Ne do të organizojmë takime edhe këtë vit nëpër komunat e Kosovës dhe do të takohemi e do të bashkëbisedojmë me anëtarësinë për të parë nga afër situatën e për të krijuar një plan të përbashkët të veprimit varësisht nga situata. Këtë vit do të vazhdojmë edhe me aktivitetet tradicionale. Në mënyrë modeste, por nga zemra do të shprehim mirënjohje për kolegët e pensionuar përmes një takimi solemn në Prishtinë. Aty presim të jenë bashkë mësimitdhënësit e pensionuar nga e tërë Kosova. Të takohen e të rikujtojnë kohët e studimeve e të rinisë. Të flasin për punën e bërë e sakrificat nëpër vite. Ata do të marrin nga SBASHK-u nga një orë dore për të kujtuar kohën e kaluar në misionin fisnik dhe nga një mirënjohje në shenjë të respektit për punën e madhe që kanë bërë në edukimin e brezave. E gëzofshin pensionin dhe u priftë e mbara dhe paçin shëndet të mirë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën tuaj elektronike Arsimiti Sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, ofron shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe bën paraqitjen e video-spotëve në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetaren e parë të SBASHK-ut : znj.Nediha Grapci

Me krenari kujtojë gjithë arritjet e SBASHK-ut nëpër vite



Nediha Grapci tani më është në pension. Ajo në kohët më të vështira të shkollës shqipe ishte në radhët e para të aktiviteteve sindikale. Angazhimi dhe përkushtimi në procesin arsimor, por edhe në aktivitetet sindikale bëri që kolegët t'i

besojnë detyrën e nënkryetares së SBASHK-ut. Natyra e saj prej një njeriu të qetë ka bërë që ajo të jetë kudo e respektuar dhe e nderuar. Nediha me dhembje krenare flet edhe për të vëllanë dëshmor Enver Hadri. Numrin e parë të gazetës sonë për këtë vit po e nisim me një intervistë përmbajtjesore me të.

Arsimimi sot:

Kush është Nediha Grapci?

Znj.Grapci:

Unë rrjedh nga një familje atdhetare. Jam e lindur në Pejë më 30 prill 1944. Shkollën fillore dhe Gjimnazin i kam kryer në Pejë e Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Punën në arsim e fillova që në moshën 18 vjeçare. Tri vitet e para kam dhënë lëndën gjuhë shqipe dhe letërsi e pastaj e bëra ndryshimin e lëndëve të Normales dhe nisa të punojë si mësuese. Në fillim si mësuese punova në fshatin Isniq të Deçanit, pastaj në Drelaj të Rugovës e po ashtu 14 vite edhe në fshatin Raushiq të Pejës. Punova pastaj plot 5 vite në Fushë Kosovë dhe së fundit 10 vite mësuese në shkollën “Naim Frashri “ të Prishtinës. Jam marrë vazhdimisht edhe me aktivitete të lira në grupin e krijueseve dhe veteraneve të arsimit. Kam qenë edhe nënkryetare e SBASHK-ut dhe nuk u jam ndarë aktiviteteve sindikale deri në vitin 2009, kur u pensionova. Jam nënë e katër fëmijëve dhe gjyshe e tre nipave dhe tri mesave. Jetoj në Prishtinë.

Arsimimi sot:

Fillimet tuaja në aktivitetet e SBASHK-ut

Znj.Grapci:

Ishte viti 1990, vit ky kur u themelua SBASHK-u. Unë isha duke punuar në shkollën fillore, tani “Selman Riza” në Fushë Kosovë . Vendosa të angazhohem bashkë me kolegët dhe ta formojmë edhe këtu sindikatën. Në Fushë Kosovë atë kohë ishte më vështirë të arrihej kjo sepse aty ishte çerdhja serbe. Madhe edhe drejtori i shkollës sonë ishte malazez. Mbledhjen e parë themeluese e kemi mbajtur në ambiente të hapura në Gërmi dhe për fatin tonë ishte kohë e mirë. . pas kësaj takimet i mbanim në shkollën “Emin Duraku” në Prishtinë. Mua në fillim më zgjodhën kryetare të sindikatës për komunën e Fushë Kosovës e më vonë më nderuan kolegët duke më zgjedhur nënkryetare të SBASHK-ut. Kishim atëherë shumë angazhime, por duhej angazhuar edhe për mirëvajtjen e procesit mësimor sepse në vitet e okupimit me dhunë ishin pezulluar organet dhe institucionet e Kosovës. Më kujtohet koha kur Serbia nisi sulmet ndaj shkollës shqipe. Ky sulm ishte shumë i ashpër në Fushë Kosovë . Me dhunë na larguan nga ambientet e shkollave dhe mësimin e vazhduam nëpër shtëpi- shkolla. Ishte ajo kohë e vështirë, por krenare ngase mësimdhënësit e Kosovës përmes SBASHK-ut u organizuan duke u kthyer në mburojë të fuqishme të arsimit. Punonim sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës. Qytetarët na përkrahnin me mundësitë e tyre dhe respekti që ata tregonin për angazhimin dhe punën tonë na frymëzonte e na jepte forcë për të qëndruar .

Arsimimi sot:

Cilat janë momentet e veçanta për ju?

Znj.Grapci:

Kam shumë momente të veçanta në jetën time, por do të veçoja çlirimin e Kosovës në vitin 1999 dhe momentin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Veçova këto dy momente sepse për to është angazhuar dhe ka dhënë jetën vëllai im Enver Hadri.

Arsimimi sot :

Kujtimet tuaja për kohën kur ishit nënkryetare e SBASHK-ut

Znj.Grapci:

Në kohë të vështira detyrë e SBASHK-ut ishte edhe angazhimi për mirëvajtjen e arsimit . Kjo ka vazhduar deri në themelimin e Ministrisë së Arsimit. Po ashtu kemi zhvilluar edhe aktivitete e takime me anëtarësinë për të bashkëbiseduar me ta për të gjitha shqetësimet. Më vonë jemi angazhuar edhe për ngritjen e mirëqenies së të punësuarve në arsim dhe kemi organizuar edhe trajnime . Kujtime të mira më kanë mbetur edhe nga angazhimet dhe tubimet solemne për ndarjen e mirënjohjeve për punëtorët më të dalluar. Moment krenarie ishte kur SBASHK-u u anëtarësua me drejta të plota në Internacionalen Botërore të Arsimit në vitin 1996. Kjo ishte arritje falë angazhimit tonë, udhëheqjes së zellshme të kryetarit të atëhershëm , Agim Hyseni dhe përkrahjes së madhe të miqve ndërkombëtar . Me respekt të lartë kujtoj edhe kohën kur SBASHK-u ishte angazhuar me gjithë mundësitë duke organizuar mësimin në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi për fëmijët shqiptarë që dhunshëm ishin dëbuar prej vatrave të tyre nga pushtuesi serb. U bë kështu një punë e madhe ngase arritëm ta shpëtojmë vitin shkollor.

Arsimimi sot:

Në vitet e 90-ta u punua me zell e sakrifica. A vlerësohen si e sa duhet ato vite?

Znj.Grapci:

Është shumë e vërtetë se në vitet e 90-ta është punuar me zell e me plot sakrifica. Në atë kohë ishte një vetorganizim i shkëlqyer. Dominonte një vetëdije e përkryer të cilën e forconte dëshira ndër dekada për liri. Të gjithë kontribuonin në mënyrën e vetë. Të punësuarit në arsim ishin kthyer në forcë të pamposhtur, kurse shumë nga qytetarët kishin kthyer

shtëpitë e tyre në shkolla. Të gjithë kishim një synim, pra lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. E, sikur mos të bëhej ky organizim nga SBASHK-u dhe të tjetër dhe sikur të mos arrihej të mbahej mësimi nëpër shkollat e Kosovës? Vetë përgjigja në këtë pyetje tregon mjaft. Por, ani edhe nëse nuk vlerësohen mjaft këto vite s'ka gjë punuam në emër të lirisë.

Arsimimi sot :

Si e shihni SBASHK-un sot ?

Znj.Grapci:

SBASHK-u tash është më e konsoliduar më një anëtarësi në nivel të duhur. Kanë kaluar 25 vite nga themelimi. Fatmirësisht gjërat kanë shkuar përpara. Janë shënuar arritje të mëdha. SBASHK-u po angazhohet vazhdimisht dhe po qëndron pranë të punësuarve në arsim dhe po plotëson vazhdimisht kërkesat e anëtarësisë.

Arsimimi sot :

Porositë tuaja për femrën sindikaliste

Znj.Grapci:

Kanë kaluar 25 vite dhe gjërat kanë ndryshuar. Tani kemi angazhim të shtuar të femrës në çdo subjekt. Po të bënim krahasime nga koha e kaluar do të thosha se në atë kohë femrat veprimtare numëroheshin në gishtërinj. Tani është situatë shumë më e mirë. Do të porosit femrat që të angazhohen edhe më shumë sepse femra edukon një familje, edukon një shoqëri. Vetëm arsimit dhe edukimit i drejtë na qon përpara.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar?

Znj.Grapci:

Përsëritës gjithë stafin e SBASHK-ut. Përsëritës ata që kanë vepruar dikur dhe ata që po punojnë e po angazhohen sot e gjithë ditën. Kemi punuar një kohë të gjatë dhe gjithmonë ishim si një familje.

Gjatë muajit

Një marrëveshje që u prit mirë nga anëtarësia e SBASHK-ut **Takimet dhe dialogu sollën rezultatin e pritur**

Në kuadër të shumë aktiviteteve SBASHK-u kishte shtuar angazhimet që në takime me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës të arrinte marrëveshje për implementimin në praktikë të nenit 8, pika 6, të Ligjit mbi Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky problem i nisur në prillin e vitit të kaluar rreth pensioneve të mësimdhënësve të Kosovës e që lidhej me vitet kontributdhënëse '89-'99 falë përkushtimit të madh të SBASHK-ut dhe vullnetit të mirë të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës ka gjetur zgjidhje pozitive.



Fillimisht delegacioni i SBASHK-ut kishte zhvilluar takime të ndara me zëvendës kryeministrin e Kosovës z.Kujtim Shala, me ministrin e Arsimit z.Arsim Bajrami, me shefin e grupit parlamentar z.Adem Grabovci. Me angazhimin e përbashkët është arritur të zhvillohet një takim me ministrin e MPMS z.Arban Abrashi me anëtarë të kabinetit të tij. Në këtë takim krahas Ministrit Abrashi ishte i pranishëm edhe Zv/Kryeministri i Kosovës, z. Kujtim Shala dhe delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari z.Rahman Jasharaj dhe menaxheri për financa dhe këshilltari për organizim të brendshëm z.Ymer Ymeri.

Është hetuar në këtë takim vullnet dhe angazhim i përbashkët andaj edhe u arrit marrëveshja që vitet '89-'99 edhe në praktikë të njihen si kontributdhënëse dhe kjo u mundëson gjithë të punësuarve në arsim që deri tani nuk e kanë gëzuar pensionin e plotë të punës të aplikojnë rishtazi.




MASHT dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes sekretarëve të përgjithshëm do të arrijnë marrëveshje lidhur me atë se vërtetimi për vitet 90-99 do të vërtetohet në shkollë dhe në DKA apo në ndonjë institucion tjetër sipas marrëveshjes. Kjo është një arritje e madhe dhe e përbashkët ngase nuk do të ketë më mësimdhënës që pensionohen e që do të ndihen të dëmtuar, por ata do ta gëzojnë pension aktual prej 158 euro dhe duke dorëzuar dokumentet tjera për kualifikimin dhe vitet e tërësishme të pensionit do të marrin pension të përshkallëzuar sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës.

SBASHK-u mbetet i sigurt se kjo marrëveshje e arritur në ambientet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale do të vihet në praktikë dhe për këtë do të kontribuojnë të gjitha palët që ishin pjesë e marrëveshjes.

SBASHK-u organizon aktivitet qendror për ditën e mësuesit

Shprehet respekt për punën e madhe të kolegëve tanë që janë pensionuar



SBASHK-u edhe këtë vit do ta kremtojë 7 Marsin, këtë datë të madhe për shkollën shqipe. Duke shprehur respektin për punën e madhe që kanë bërë anëtarët e SBASHK-ut nëpër vite e dekada do të vazhdohet me traditën

e mirë që me rastin e festës së tyre gjithë anëtarëve të SBASHK-ut që janë pensionuar nga prilli i vitit 2015 e do të pensionohen deri më 7 mars 2016, SBASHK-u do të nderojë ata me mirënjohje dhe me nga një orë dore. U ndahen mirënjohje duke dëshmuar publikisht respektin për përkushtimin e këtyre njerëzve në përmbushje të misionit human të edukimit e arsimit të brezave. U dhurohen orët për të kujtuar kohët e kaluara në shërbim të anëtarësimit shqip gjatë gjithë viteve, që edhe nuk ishin të lehta.

Për t'ia shtuar madhështinë kësaj dite të shënuar Kryesia e SBASHK-ut ka vendosur që të ketë risi në traditën e mirë. Manifestimi dhe takimi me anëtarët e pensionuar do të mbahet në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë e në të njëjtin vend. Ata më 5 mars, në orën 12, do të jenë të gjithë në Prishtinë në Pallatin e sporteve "1 Tetori". Ky moment solemn do t'u mundësojë këtyre njerëzve të devotshëm që të takohen



me kolegët nga të gjitha viset e Kosovës dhe të kujtojnë ditët e studimeve. Ata do të kujtojnë edhe momentet e kaluara në shërbim të misionit human në betejat për dituri të reja.

“Ky solemnitet do t'i bëj bashkë edhe një herë të pensionuarit në arsim e që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në ditën e madhe të mësuesit. Do të jenë në të njëjtin vend pishtarët e shkronjave shqipe. Kështu SBASHK-u Shpreh respekt për punën e madhe të kolegëve tanë që janë pensionuar. Besoj se kryetarët e niveleve komunale dhe veprimtarët tjerë sindikalë do të bëjnë gjithë angazhimet dhe të gjithë të pensionuarit nga prilli i vitit të kaluar e deri më 7 mars të këtij viti do të jenë në festën e përbashkët”, është shprehur kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj.

SBASHK-u vazhdon bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar

Një grup intelektualësh slloven vizituan SBASHK-un

Qendra për Hulumtime dhe Zhvillime Edukative e Kosovës në bashkëpunim me Shkollën Ndërkombëtare për Studime Sociale dhe të Biznesit nga Sllovenia kishin organizuar më 11 janar në Prishtinë Konferencën Ndërkombëtare për Cilësi dhe të Mësuarit elektronik në Arsim.

Delegacioni nga Sllovenia në kuadër të qëndrimit në vendin tonë e duke pasur respekt për punën dhe angazhimet e SBASHK-ut ka shprehur dëshirën për një takim në selinë e sindikatës sonë. Intelektualët

Dr. Valerij Dermol, Dr. Andrej Koren, mr. Anja Lesjak, Dr. Dushan Lesjak dhe dr. Nada Trunk Shirca, të shoqëruar nga drejtori Ekzekutiv i Qendrës për Hulumtime dhe Zhvillime Edukative, z. Bashkim Greiçevci janë pritur nga kryetari i Rahman Jasharaj, nënkryetarët Lutfi Mani e Rexhep Sadiku, menaxheri financiar dhe këshilltari për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafi i SBASHK-ut. Në fjalën përshëndetëse Dr. Valerij Dermol ka lavdëruar angazhimet e sindikatës sonë dhe shprehur i gatshëm

për bashkëpunim me SBASHK-un.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fjalën e tij të mirëseardhjes për mysafirët ka bërë një

shpalosje të historikut të SBASHK-ut që nga themelimi i e deri sot. “Gjithë arritjet e mëdha në SBASHK-ut janë falë angazhimit të anëtarësisë dhe veprimtarëve, por edhe të ndihmës së miqve ndërkombëtar duke veçuar edhe Sindikatën e Arsimit të Sllovenisë, Holandës, Gjermanisë dhe të anëtarëve të Internacionales Botërore të Arsimit”, është shprehur kryetari i SBASHK-ut duke kujtuar bashkë me mysafirët vitet e vështira të arsimit shqip në kohën e okupimit dhe përpjekjet e mëdha dhe plot sakrificat të anëtarëve të SBASHK-ut në mbrojtjen e arsimit shqip në ato vite.

Në vend të përkujtimit

Vdekja e ndau nga ne kolegun Xhavit Rama



Lajmi për vdekjen e cilit do njeri të krijon ndjenjën e dhembjes. E kur ky lajm vjen për njeriun që e ke njohur nga afër kjo dhembje është shumë më e madhe dhe krijon një zbrazëti. Një lajm i tillë na erdhi pa prituri për kolegun tonë

Xhavit Rama. Në shkollën e tij heshtje plot dhembje. Atmosferë e njëjtë në qytet dhe në SBASHK. Gjithë ata që e njohën këtë njeri e kujtojnë me respekt sepse ai e meritonte respektin.

Kur njeriu mbetet pa një shok të mirë sepse ai ka shkuar në amshim kujtimet nisin punën e vet. Më kujtohet çdo herë kur kishim sfida dhe pikëpyetje të shumta se çka po bëhet e si do të bëhet, vinte Xhavit Rama në selinë e SBASHK-ut. Vinte plot energji pozitive dhe na jepte guxim e kurajë. Bisedat me të merrnin gjithnjë ngjyrim pozitiv. I tillë ishte Xhavit edhe në shkollë edhe në shëtitje. Krijonte atmosferë miqësore dhe prandaj ai kishte vetëm miq e as edhe një armik. Të gjithë e donin dhe e respektonin Xhavitin.

Vdekja e ndau nga ne kolegun Xhavit Rama, por kujtimi për të do të jetë i përjetshëm.

Përfaqësues të Qendrës për Politikë dhe Avokim vizituan SBASHK-un **Gatishmëri e ndërsjellë për bashkëpunim të frytshëm**

Përfaqësuesit e Qendrës për Politikë dhe Avokim , z. Milaim Morina dhe z. Agim Kelmendi kanë vizituar selinë e SBASHK-ut dhe janë takuar me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe me anëtarë të tjerë të kryesisë. Kryetari i SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj duke iu dëshiruar mirëseardhje mysafirëve ka bërë një shpalosje të historikut të pasur të SBASHK-ut. Ai pastaj bashkë me stafin e SBASHK-ut u janë përgjigjur shumë pyetjeve të z. Morina e Kelmendi e që kishin të bënin me angazhimet konkrete , me arritjet dhe me sfidat e kësaj sindikate, që është më e madhja dhe më aktivja në Kosovë. Kryetari Jasharaj ka thënë se është uniteti ai që e bën të fortë SBASHK-un e pastaj ka treguar se po vazhdohet me aktivitetet në shërbim të anëtarësisë. Jasharaj ka lavdëruar edhe bashkëpunimin me sindikatat simotra në Ballkan, Evropë e kudo në botë e duke veçuar edhe

bashkëpunimin me Internacionalen Botërore të Arsimit që numëron 31 milionë anëtarë, pjesë e të cilës me të drejta të barabarta është edhe SBASHK-u që nga viti 1996. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë deklaruar se janë angazhuar e do të vazhdojnë se angazhuari për të ndikuar në përpilimin e ligjeve dhe në implementimin e tyre si dhe në realizimin e plotë të Kontratës Kolektive për sektorin e arsimit parauniversitar dhe për nënshkrimin e Kontratës për Universitetin

Përfaqësuesit e Qendrës për Politikë dhe Avokim , z. Milaim Morina dhe z. Agim Kelmendi kanë shprehur respekt për gjithë arritjet dhe angazhimet e SBASHK-ut dhe kanë deklaruar se Qendra që përfaqësojnë ata është e gatshme për një bashkëpunim të sinqertë me SBASHK-un. Të dy palët janë pajtuar që takime të përbashkëta të organizohen edhe në vijim.